



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 30.01.2025**

**PËR**

**ZËVENDËSIMIN E NËPUNËSIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN ZNJ. {...}  
DHE ZNJ. {...}, NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE  
PROFESONAL TË GJYQTARËVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 89 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 12 të Vendimit të e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në vendimin nr. 22 prot., datë 08.04.2024 “Për komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e Këshilltarit Ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, urdhrin nr. 22 prot., datë 08.04.2024 “Për caktimin e znj. {...} në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr.17, datë 18.01.2024 “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “Nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale:

**VENDOSI:**

1. Zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim, znj. {...}, në procedurën e papërfunduar të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, periudha e vlerësimit 2017-2019, me nëpunësen përgjegjëse për vlerësim, znj. {...} Zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim, znj. {...}, në procedurën e papërfunduar të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, periudha e vlerësimit 2020-2022, me nëpunësen përgjegjëse për vlerësim, znj. {...}.
2. Zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim, znj. {...} në procedurat e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2021-2023, me nëpunëset përgjegjëse për vlerësim, si më poshtë:
  - a) Për gjyqtaren znj. {...}- nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. {...}
  - b) Për gjyqtarin z. {...}- nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. {...}
  - c) Për gjyqtarin z. {...}- nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. {...}
3. Zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim, znj. {...} në procedurën e papërfunduar të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarës që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar znj. {...}, dhe caktimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**